



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:098567
Datë: 15.08.2024
Numri i dokumentit: 06054922

AC-I-23-0281

Në ankesën e

Paditësit/Ankuesit

S B N, S N N, Z P N të përfaqësuar nga avokat, B M nga Podujeva dhe S A D avokate nga Prishtina.

Te paditurat

NSH, KBI ,, Progres Eksport"-Lavërtari Blegtori, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditëseve të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-17-108 të datës 28 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 08 gusht 2024, me shumicë votash, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. Ankesa e paditësve është e bazuar.

II. Ndryshohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-III-17-0108 i datës 28 prill 2023, lidhur me kërkesëpadinë që ndërlihet me ngastrat nr.,.,., .dhe . ZK L KK Prizren.

III. Aprovohet kërkesëpadia e paditësve, dhe paditësve u njihet e drejta e kthimit të patundshmërive-ngastrave vijuese kadastrale:

- nr... me sipërfaqe prej 0.13.40 ha, ZK L KK Prizren,
- nr. ,, me sipërfaqe prej 0.28.85 ha, ZK L, KK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.51.69 ha, ZK LKK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.07.05 ha, ZK LKK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.27.34 ha, ZK LKK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.30.40 ha ZK LKK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.03.73 ha, ZK LKK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.04.15 ha, ZK LKK Prizren,
- nr.. me sipërfaqe prej 1.62.97 ha, ZK L KK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.25.10 ha , ZK LKK Prizren,
- nr..,me sipërfaqe prej 0.12.39 ha, ZK LKK Prizren,
- nr..,me sipërfaqe prej 0.09.99 ha, ZK LKK Prizren,
- nr.., me sipërfaqe prej 0.30.00 ha, ZK L KK Prizren,
- nr. ,, me sipërfaqe prej 0.29.35 ha, ZK LKK Prizren,
- nr. ,, me sipërfaqe prej 0.44.00 ha, ZK LKK Prizren.

IV. Detyrohet e paditura që paditësve tua kthej në pronësi dhe posedim të lirë paluajtshmëritë- ngastrat kadastrale të cekura në piken III të këtij dispozitivi, si dhe të ja mundësoj paditësve bartjen-regjistrimin e këtyre ngastrave në regjistrin kadastral.

V. Kundërpadia e të paditurës/AKP-së, lidhur me kthimin e prestimeve-të hollave të paguara nga NSH KB "Progres Export"-Lavërtari Blegtori, Prizren, në emër të blerjes së palujtëshmive lëndore të Kontratave të anuluar të shitblerjes , kthehet në rigjykim tek gjyqtari përkatës i DHPGJS-së.

VI. Masa e sigurisë e caktuar me Aktvendimin e Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS, C-III-17-0108 të datës 13 nëntor 2020, nuk prodhon më efekte juridike.

VII. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 26 mars 2003 paditësit me padi kanë kërkuar tu njihet e drejta pronësore lidhur me ngastrat kadastrale që ishin objekt i kontratave të anuluar me Aktgjykimin C. nr. 1648/92, të dt. 26.10.1993, në bazë të kërkesës së Prokurorit Publik Komunal në Prizren, kontrata e shitblerje Leg nr. ., dt..., për ngastrat nr. ., ., ., ., kontrata e shitblerjes, Leg nr. ., dt..., për ngastrat nr., ., . ., dhe . dhe kontrata e shitblerjes Leg, nr. ., dt..., për ngastrat ., ., . ., ., ... Këto kontrata ishin të lidhura në mes parardhësve të paditësve të ndjerë B J N , N J N dhe P J N të gjithë nga fshati L si dhe të paditurës NSH,,Progres ” .

Me 17 maj 2010, Gjykata Komunale në Prizren ka marrë Aktgjykim C. nr. 797/03, me të cilin ishte aprovuar padia e paditësve si e bazuar dhe i padituri NSH,, Progres ” ishte obliguar t’ua dorëzojë paditësve në posedim dhe shfrytëzim ngastrat kadastrale në vijim : ngastrën nr. .. me sipërfaqe prej 0.11.58 ha, ngastrën nr. ., me sipërfaqe 0.14.42ha, ngastrën nr., me sipërfaqe 0.15.50ha, ngastrën ., me sipërfaqe 0.15.96ha, ngastrën . me sipërfaqe 0.40.74, ngastrën nr., me sipërfaqe 0.06,28 ha, ngastrën nr. . me sipërfaqe 0.06.50ha, të gjitha të regjistruara në fletën e posedimit.. ZK L . Pala e Paditur ishte e obliguar t’ ia lejoj paditësve për tu regjistruar si bashkëpronar në emër të paditësve B N, M K N,R S, N dhe V B N 1/20 pjesë ideale, paditësit D N, Z N1, Z N2, Z T N, B Z N nga 1/20 pjesë ideale, ndërsa paditësi S N në ¼ pjesë ideale në Drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës në Prizren. Në paragrafin II të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata kishte vërtetuar se padia është tërhequr në pjesën ku paditësit kishin kërkuar dorëzimin e posedimit të ngastrës . sipas listës së posedimit . ZK L.

Me 14. mars 2011, AKP-ja ka parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke kërkuar që aktgjykimi të ndryshohet dhe padia të refuzohet si e pa bazuar.

Me 27 prill 2017, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, me aktvendim AC – II- 12- 0157, ka aprovuar ankesën e të paditurës, e ka anuluar aktgjykimin C. nr. 797/03, të dt. 17 maj 2010 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim tek Kolegji i Specializuar i DHPGJS.

Me 11 mars 2011, Referentja e Gjykatës, ka mbajtur një shënim zyrtar me të cilin ka konstatuar se mungojnë shkresat e lendes, AC 175/2011.

Me 11 gusht 2017, AKP-ja, ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj padisë, me të cilën ka paraqitur kundërshtimet e veta të natyrës procedurale në lidhje me hartimin e padisë e cila është në kundërshtim me nenin 27.4 të Shtojcës së ligjit 04/L-033, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, të Kosovës si dhe nenin 253 të LPK-së . Ka theksuar se palëve u mungon legjitimiteti aktiv për të qenë palë paditës sepse nuk kanë prezantuar dokument që janë trashëgimtar të paraardhësve të tyre. Padiësit nuk kanë ofruar dëshmi se janë pronarë të ngastrave. Ka kërkuar të hedhet poshtë padia.

Me 30 korrik 2020, avokati B M, ka dorëzuar parashtresën me të cilën e ka njoftuar Gjykatën se nga paditësit S N, S N, dhe Z N ka marr autorizimin bartës, nga avokati S R nga Prizreni, të vërtetuar te noteri A M M.

Me 05 gusht 2020, avokati S R ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka bërë precizimin e padisë në pikëpamje subjektive, dhe me rastin e precizimit është deklaruar se pas vdekjes së N N si trashëgimtar i vetëm ligjor është shpallur S N lajmërimi i noterit kompetent nr. 22/2017, më dt. 29.11.2017, pas vdekjes së P N si trashëgimtar i vetëm është shpallur Z N sipas aktvendimit për trashëgimi dt. 14.11.2017, dhe mbas vdekjes së B N si trashëgimtar i vetëm është shpallur S N sipas lajmërimit të noterit kompetent.

Me 17 gusht 2020, avokati B M ka dorëzuar propozimin për masë të sigurimit.

Me 12 tetor 2020, AKP-ja, ka dhënë përgjigje në propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

Me 14 tetor 2020, Shkalla e parë e Dhome së Posaçme të Gjykatës Supreme ka lëshuar Urdhër C- III- 17- 0108, për të autorizuarin e paditësve për dorëzimin e një kopje të vërtetuar nga origjinali i Aktgjykimit C. nr.1648/92, më dt. 26.10.1993, të Gjykatës Komunale në Prizren, i pajisur me klauzolë të plotfuqishmërisë.

Me 27 tetor 2020, avokati B M ka dorëzuar parashtresën me të cilën edhe ka dorëzuar aktgjykimin të vërtetuar nga origjinali, C.nr. 1648/92, dt. 26.10.1993.

Me 13 nëntor 2020, Shkalla e parë e DHPGJS-së, ka marrë Aktvendim C- III- 17- 0108 me të cilin është caktuar masa e sigurimit dhe kundërshtarit të sigurimit NSH Progres ju është ndaluar që të ndër marr çfarëdo veprimi të tjetërsimit në ngastrat nr. . . , . , . , . , . , . , . , . , dhe . , ZK L.

Me 14 janar 2021, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme e ka vërtetuar Aktvendimin C- III- 17- 0108, dt. 13 nëntor 2020, për caktimin e masës së sigurimit.

Me 01 korrik 2022, avokati B M ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar në lidhje me ekzistimin e legjitimitetit aktive të paditësve, ndërsa në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren është deklaruar se i njëjti është i plotfuqishëm andaj ngastrat të cilat janë në fletën e posedimit nr., ZK L janë të regjistruara në emër të KBI „Progres Prizren “. Me këtë parashtresë ka dorëzuar Aktvendimin e nxjerr nga Komuna e Prizrenit, shenja, 07- 463-0454932/B, dt. 29.06.2020, me të cilin Komuna/ Zyra e Kadastrës ka refuzuar kërkesën e S N për bartjen e pronësisë nga pronari i deritanishëm KBI „ Progres “ e cila kërkesë është mbështetur në aktgjykimin C. nr. 1648/92, të Gjykatës Komunale në Prizren. Në arsyetim të aktvendimit, refuzues është theksuar se aktgjykimi në fjalë ka të bëjë me anulim kontrate dhe për zbatimin në kadastër është e nevojshme të bëhet aktgjykimi tjetër për dorëzimin në posedim të palujatshmerive, objekt i kontratave Leg ., ., dhe nr.. Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesë në afatin prej 30 ditëve në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Nuk ka provë se kundër këtij aktvendimi 07- 463-0454932/B, dt. 29 qershor 2020 është ushtruar ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

I autorizuari i paditësve me parashtresë, dt. 23 janar 2023, ka dorëzuar edhe një raport me shkrim të ekspertes L R, dt. 13.10.2009 me të cilin është bërë identifikimi i ngastrave të cilat kanë qenë objekt i kontratave tani më të anuluar me aktgjykimin C. nr. 1646/93 , të Gjykatës Komunale në Prizren.

Me 25 janar 2023, Gjyqtari i shkallës së parë ka marr Urdhër për bashkimin e padive , C – III- 17- 0108, C- III- 18- 0109, dhe C- III- 19- 0097, dhe lënda është udhëhequr sipas shenjës C- III- 17- 0108.

Me 25 janar 2023, Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar njoftimin për palët ndërgjyqës në lidhje me bashkimin e lëndëve, dhe ju ka mundësuar palëve që edhe një herë të bëjnë shikimin e shkesave të lëndës, si dhe ju ka dhënë mundësi edhe një herë të deklarohen me shkrim në lidhje me çështjen e objektit të kontestit .

Me 08 shkurt 2023, AKP-ja, përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar në çështjet e ngritura për legjitimitetin aktiv të paditësve, pastaj në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 1648/92, dt. 26.10.1993, me të cilin janë shpallur nul kontratat e shitblerjeve dhe në çështje të tjera.

Me 27 shkurt 2023, avokati B M me parashtresë ka bërë precizimin e kërkesëpadiësë.

Me 06 prill 2023, Shkalla e parë, ka caktuar seancë dëgjimore publike, në të cilën për paditësit, kanë prezantuar avokati B M dhe avokate S D A , ndërsa për të paditurën ka prezantuar V H.

Për paditësit i autorizuari i paditësve, avokati B M në seancë është deklaruar se kemi të bëjmë me vërtetim dhe njohje pronësie, dhe lidhur në mes palëve kemi një aktgjykim të formës së prerë me të cilin janë anuluar kontratat, dhe qëndrojmë pran precizimit të kërkesëpadiësë, dt. 27.02.2023.

Përfaqësuesja e AKP-së, në seancë është deklaruar se nuk është shumë e qartë se në këtë rast kush kënd po e përfaqëson, pastaj është deklaruar se e kundërshton legjitimitetin aktiv të paditësve dhe nuk është e qartë se paditësit në padinë bazë a' janë tërhequr , pasi tani kemi vetëm tre paditës. Më tej ka ngritur çështjen e interesit juridik për këtë padi sipas nenit 2.4 të Ligjit për procedurë kontestimore .

Më 28 prill 2023, Shkalla e parë e DHPGJS ka marrë Aktvendimin në piken I hedhet si e pa pranueshme padia e paditësve S B N S N N Z P N të gjithë nga Prizreni me të cilën kanë kërkuar Anulimin dhe deklarimin nul të kontratës Leg nr. ., dt. ., të kontraktuar në mes N N dhe KBI Progres, për ngastrat nr. .. ., ., ., . ., ., ZK L ,

Anulimin dhe deklarimin nul të kontratës Leg nr. ., dt..., të kontraktuar në mes P N dhe KBI Progres, për ngastrat ., ., ., . ., ZK L Anulimin dhe deklarimin nul të kontratës Leg nr. ., dt..., të kontraktuar në mes B N dhe KBI Progres, për ngastrat nr. ., ., . ., ., ., ZK L. Në piken II ka shfuqizuar aktvendimin për caktimin e masës së sigurimit, C- III- 17- 0108, të dt. 13 nëntor 2020, në momentin kur aktvendimi sipas paragrafit një bëhet i formës së prerë. Pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi, kryesisht një kopje ti dërgohet Zyrës së Kadastrës pranë Drejtorisë së Kadastrës, në Komunën e Prizrenit. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës.

Në arsyetim të Aktvendimit thuhet Gjykata, përkundër faktit se në procedurën me shkrim ka kërkuar sqarime dhe ka lëshuar urdhra për precizimin e kërkesëpadiisë, nga i autorizuari i paditësve sikundër edhe për evitimin e pengesave procedurale për të cilat kujdeset kryesisht, vendosi të mbaj një seancë dëgjimore publike me të cilën vendosi t' ju jepet mundësin edhe gojarisht të deklarohen palët ndërgjyqës. Me dispozitën e nenit 391 të Ligjit për procedurë kontestimore (LPK) është paraparë,, Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendime e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur në padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore, b) palët kanë lidhë kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazhi, c) për çështjen e ngritur në padi ekziston gjyqëvarsia , d) çështja është gjë e gjykuar.

Me dispozitën e nenit 166, paragrafi 2, të LPK është paraparë,, Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a' mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur në padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e pa lejuar ”.

Me nenin 167.2, të LPK-së është paraparë, Forma e prerë e aktgjykimit lidhet për gjendjen e raportit juridik në kohën e përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes”. Me aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prizren C. nr. 1648/92, e iniciuar nga Prokurori publik në Prizren për anulim kontrate është vendosur: ,, PRANOHET kërkesëpadia e Prokurorit publik e Komunës së Prizrenit, dhe vërtetohet që janë të pavlefshme kontratat për shitblerje Lef, dt. ., të lidhura në mes N N , dhe KBI Progres, kontrata leg nr. ., dt..., e lidhur në mes P N dhe KBI Progres, dhe kontrata leg ., e lidhur në mes B N dhe KBI Progres, të gjitha kontratat e vërtetuara në

Gjykatën Komunale në Prizren, të gjithë janë të obliguar ta pranojnë në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi me kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm

Secila palë i heq shpenzimet e veta të procedurës.

Aktgjykimi C. 1648/92 është bërë i formës së prerë, më dt. 29. IV.1994.

Tutje ka arsyetuar se sipas parashtresave të avokatit B M për precizimin e kërkesëpadisë, dt. 01.07.2022, dt. 22.07.2022, dt. 27.02.2023, është kërkuar: "Anulimin dhe deklarin nullo të kontratës Leg nr. ., dt. ., të kontraktuar në mes N N dhe KBI Progres, për ngastrat .. ., ., ., ., ., ZK L . Anulimin dhe deklarin nullo të kontratës Leg nr. ., dt..., të kontraktuar në mes P N dhe KBI Progres, për ngastrat nr. ., ., ., ., ., ZK L . Anulimin dhe deklarin nullo të kontratës Leg nr. ., dt..., të kontraktuar në mes B N dhe KBI Progres, për ngastrat ., ., ., ., ., ZK L ”.

Pra në rastin konkret kërkesëpadia e paditësve sipas parashtresave është e njëjtë, me kërkesën e cila është gjykuar, me aktgjykimin C. nr. 1648/92, të Gjykatës Komunale në Prizren e që është bërë i formës së prerë, më dt. 29.04.1994.

Shkalla e parë ka vlerësuar se nisur nga fakti se kontesti për anulim të kontratave, në mes palëve ndërgjyqës, ka përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C nr. 1648/92, dhe aktgjykimi është bërë i formës së prerë më dt. 29.04.1994, pra para se të jetë themeluar Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ashtu që për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për AKM-në, nuk është paraparë ndonjë dispozitë e Rregullores së UNMIK –ut, nr. 2002/13, për Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për AKM , sikundër edhe me Ligjin 06/L-086, se aktgjykimet e gjykatave të rregullta që kanë vendosur në lidhje me çështje pronësore, të cilat janë bërë të formës së prerë, para themelimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për AKM , do ti nënshtrohen ndonjë vlerësimi .

Shkalla e parë në arsyetim thekson se në rastin konkret, duke marrë për bazë faktin se për kërkesëpadinë e paditësve, kundër të paditurës, në lidhje me anulimin e kontratave Leg nr. ., dt. ., Leg nr. ., dt... Leg nr. ., dt... me aktgjykim të formës së prerë, është gjykuar, për të njëjtën kërkesë në mes palëve të njëjta ndërgjyqës nuk mund të ketë gjykim tjetër, sepse kemi të bëjmë me gjë të gjykuar sipas dispozitës së nenit 166, paragrafi 2, të LPK . Aktgjykimi, C. nr. 1648/92, i Gjykatës Komunale në Prizren që është bërë i formës së prerë më dt.29.04.1994, ka efektin e vet juridike si për paditësit si pasardhës nga paraardhësit e tyre, të paditurin NSH Progres, ashtu edhe për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për AKP –në dhe se Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme është e lidhur për vendimin e formës së

prerë. Aktgjykimi C. nr. 1648/92, pra ka efektin e vetë formal juridik sepse, paraqet si pengës procedurale për gjykim tjetër, pra nuk mund të vendoset dy herë për të njëjtën çështje, parimi ne bis in idem, por edhe ka efekt material juridik pasi aktgjykimi në fjalë ka prodhuar efekt juridik për palët ndërgjyqës, në lidhje me çështjen kontestuese të nulimit të kontratave. Gjykata vlerëson se Aktgjykimi C.nr. 1648/92, i Gjykatës Komunale në Prizren, që është bërë i formës së prerë më dt. 29.04.1994. Padiësve ju jep bazën juridike për të kërkuar regjistrimin e të drejtës së tyre pronësore në regjistrin e palujatëshmerive, në Zyrën e Kadastrit në Komunën e Prizrenit, sipas Ligjit nr. 04/L-009, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2002/5, dispozita e neni 4, me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar neni 3, paragrafi 3.7. Shkalla e parë ka vlerësuar se Aktvendimit i Komunës së Prizrenit, Drejtoria e Kadastrës me shenja, 07- 463-0454932/B, dt. 29.06.2020, nuk paraqet si pengesë ligjore për padiësit të ushtrojnë kërkesën e re për regjistrim në Zyrën e Kadastrit, të mbështetur sipas dispozitave të Ligjit për Themelimin e Regjistrit të Palujatëshmerive 2002/5, me plotësime dhe ndryshime.

Me rastin e hedhjes së padisë, Shkalla e parë ka zbatuar dispozitën e nenit 36, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Suprem të Kosovës për AKP –në, e në lidhmeri me nenin 391, paragrafi 1 pika d) , dhe nenin 166 paragrafi 2 të LPK-së, dhe u vendos si në paragrafin një të dispozitivit. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se, padia e padiësve është hedhur si e pa pranueshme, vendosi ta shfuqizon aktvendimin C- III- 17- 0108, dt. 13.11.2020, për caktimin e masës së sigurimit, pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi për hedhje të kërkesëpadiës, për shkak se me këtë aktvendim ka rënë edhe baza juridike për ekzistimin e masës së sigurimit.

Me 15 maj 2023, padiësit/ankuesit nëpërmjet përfaqësuesit të tyre e kanë dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-III-17-108 të datës 28 prill 2023, me të cilën kanë propozuar që të ndryshohet vendimi i shkallës së parë , të provohet në tersi ankesa e padiësve trashegimatëret e pronarve origjinal, të vërtetohet se padiësit janë pronar të ngastrave kadastrale të listuar dhe të përshkruara në ekspertizën si në vijim: Si pasojë e anulimit dhe deklarimit nul nga ana e Gjykatës Komunale në Prizren me aktgjykim e plotfuqishëm Cnr.1648/92, te urdhërohet shërbimi Kadastral në Prizren që plaujtshemritë e cituara në pikën I të dispozitivit sipas listës, të regjistrohen në pronësi të padiësve, të Obligohet e paditura që ta pranojë dhe ta

lejoj regjistrimin në Drejtori për Kadastër dhe Gjeodezi dhe mos ta pengojë posedimin dhe shfrytëzimin e lirë të tyre, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbartimit me dhunë.

Përfaqësuesi i paditësve në ankesën e parashtruar ka theksuar se meqenëse gjatë procedurës në padi dhe sidomos në precizimin verbal të padisë gjatë seancës së mbajtur me datë 06 prill 2023 (shih bashkangjitur procesverbalin e asaj seance) potencon se kanë kërkuar gjithnjë njohjen e pronësisë dhe regjistrimin e pronës për kadastër në emër të paditësve për vetë faktin që ekziston një vendim i plotfuqishëm i gjykatës Komonale në Prizren që ka deklaruar nul kontratat Leg, duke e kthyer gjendjen faktike në situatën e mëparshme, dhe se kanë mbetur të habitur kur kanë lexuar këtë llojë përgjigje nga gjykata.

Paditësit me ankesë theksojnë se janë përmendur shpesh kontratat leg respektivisht të secilit trashëgimtar paditës por njëkohësisht është elaboruar gjerësisht dhe në detaje edhe fakti që në bazë të vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Prizren tashmë ato kontrata janë deklaruar nul, prandaj nuk ekziston arsye pse të kërkonin përsëri anulimin e tyre.

Në ankesë ankuesit kanë theksuar se në propozimin për masë të përkohshme të sigurisë, e aprovuar nga shkalla e I-rë e Dhomës së Posaçme dhe vërtetuar nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, (shih dokumentin e bashkangjitur) është shkruar shprehimisht: " paditësit Sr N, S N dhe Z N nga Prizreni kanë ushtruar padi më 26 mars 2003, ndaj të paditurës KBI Progres – Lavëratari Blegtori, Prizren në shih Gjykatën komonale në Prizren me të cilën kërkojnë nga Gjykata që tu njohët e drejta pronësore lidhur me ngastrat kadastrale objekt të kontratave të anuluar me aktgjykimin C. Nr.1648/92 të datës 26 tetor 1993. Në padi paditësit njoftojnë se pas anulimit të këtyre konstartave, pronat subjekt të këtyre kontratave, pa asnjë bazë ligjore e ka mbajtur dhe vazhdon ti mbajë NSH-ja e paditur, e paditura nuk ka treguar asnjë arsye se pse i mban akoma në administrim pa të drejtë këto prona që do të duhej prej kohësh të ishin në emër të paditësve."

Në ankesë përfaqësuesi i paditësve ka theksuar se paditësit dhe avokati në emër të tyre kanë bërë listimin (radhitjem) e parcelave pronësore siç kanë qenë të shprehura në kontratat leg, për të treguar se cilat ishin këto parcela pronësore që do të duhet të regjistrohen në emër të tashegimatarve paditës dhe ndërkohë

kolegji gjykues këtë e ka interpretuar gabim si kërkesë për anulim të kontratave Leg. Tashmë të deklaruara nul prej vitesh.

Ankuesit nëpërmes ankesës theksojnë se janë edhe dy Aktvendime të Zyrës Kadastrale në Prizren të datës 09 janar 2020 dhe 29 qershor 2020 të cilat në fakt nuk kanë pranuar kërkesën për regjistrimin e pronave në kadastrer në emër të trashëgimatrve ligjor paditësve megjithëse ndërkohë pranojnë faktin që kontratat Leg janë deklaruar nul, dhe kërkojnë shprehimisht në të dy dokumentet (shih bashkangjitur aktvendimet e Zyrës Kadastrale) që " për zbatimin në kadastrer është e nvojshme që të bëhet aktgjykim tjetër mbi dorëzimin në posedim të paluajtshmerive.

Ankuesit në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit theksojnë se ata kanë kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë në emër të paditësve / ankuesve trashëgimtare të pronarëve origjinal , si edhe urdhrin për regjistrimin e tyre në shërbimin kadastral. Ndërsa kërkesa si në padi ashtu edhe në precizimin që është bërë gjatë seancës së fundit përpara kolegjit gjykues precizimi i bërë si pasojë e kemnguljes së gjykatës që objekt i kontestit ishte anulimi i kontratave. Gjykata edhe gjatë seancës vazhdoi të shprehej që parashtruesat nga ana e mbrojtjes kinse kanë kërkuar anulimin e kontratave leg, qka në gjë e tillë nuk qëndron sepse anulimi i kontratave ka ndodhur në vitin 1992 nga gjykata kompetente me anë të aktgjykimit të formës së prerë. Duke evidentuar këtë interpretim të gabuar nga ana e gjykatës megjithëse të bindur në gabimin e kolegjit gjykues neve u detyruam të deklarohejmë që : nëse është nevoja edhe tani në seancë e korrigjojmë atë fjali e cila interpretohej në atë mënyrë nga gjykata. Këtë e lejon dispozita e nenit 258.1 të LPK-së.

Ankuesit /paditësit kanë theksuar se nuk do të mund të bënin tjetër kërkesë përveç njohjes së pronësisë, nisur edhe nga gjithë paditë shkruara dhe të dorëzuara më parë në mënyrë që paditësve të dorëzohen në posedim mbajtje , në shfrytëzim të lirë dhe disponim paluajtshmeritë.

Me 30 prill 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se paditësit nuk i kanë paraqitë provat e besueshme përmasë së cilës kërkohet mbrojtja e të drejtës së pretenduar. Thëniet, deklaratat e ankuesit të parashtruara në arsyetimin e ankesës nuk kanë fuqi të argumenteve ligjore

dhe ato si të tilla nuk janë dëshmi e plotë dhe e pa kontestueshme fakti se, vërtetet kërkesa e paditësit është pa bazë ligjore.

AKP-ja konsideron se pretendimet e ankesës, se Gjykata e shkallës së parë është përfshirë në shkelej thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nuk qëndron dhe është i pathemeltë. Ka shtuar se përfaqësuesi i paditësve asnjëherë nuk e beri precizimin e padisë të qartë, por vazhdimisht kërkonte dhe deklaroheshin anulimi i kontratave të shitblerjes. AKP konsideron se gjykata e çështjes aktvendimin e ka marrë në pajtim me nenin 76.3, të Ligjit Nr.06/L-086, ashtu që Aktgjykimi i atakuar nga ankuesi është mjaft i qartë dhe përmban shpjegime dhe arsye të mjaftueshme, mbi bazë të provave të administruara nga gjykata të dhëna në arsyetimin e aktvendimit. Gjykata ka arsyetuar te gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar sipas pretendimeve përgatitore është në përputhje me të drejtën materiale, siç edhe e ka dhënë arsyetimi të mjaftueshëm. AKP-ja po ashtu ka theksuar se paditësit me ankese po tentojnë ta ndryshojnë kërkesë padinë, e që një veprim i tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPK-së me të cilin qartë është përcaktuar periudha kohore për ndryshim, precizimin dhe plotësim të padis. Paditësit për përmes ankesës tani po kërkojnë kthimin e peronës sipas Aktgjykimit në Gjykatën komunale në Prizren C. Nr.1648/92 të datës 17 janar 1994 me të cilin janë shpallur nule kontratat e shitblerjes sipas nenit 8 të Ligjit të RSS-së nr.43/81 ,mbi Qarkullimin e pasurisë së patundshme i ndryshuar me Ligjin 28/87 të RSS-së (LQPP). Lidhur me nulitetin e kontratave të kësaj periudhe, Kolegji i Apelit në Aktgjykimin me nr.AC-I.-15-0266 e datës 29 gusht 2019 ka dhënë arsyetimin ligjor nder tjerash :

“ në lenden në fjalë si “ moment i veprimit” duhet të konsiderohet miratimit i nenit 8 a të LQPP-së i cili parashikon mjetin juridik kundër kontratave të lidhura para atij viti. Prandaj, personat e interesuar kishin maksimumin 10 vite duke filluar nga viti 1987 që të kërkojnë në bazë të nenit 8 a dhe ai afat mbaroi në vitin 1997”. Në rastin konkret , procedura është dashur të vazhdohet sipas dispozitave ligjore të ligjit si më sipër, dhe nisur nga kjo rrethanë e pa kontestuar faktike, e paditura konsideron se padia e paditësve është parashkruar sepse nuk ka përfunduar brenda periudhës 10 vjeçare për realizimin e të drejtës së pretenduar. Paditësit e kanë lëshuar këtë afat kohor prej 10 viteve, nuk i kanë plotësuar kriteret që këto procedura ti udhëheqin nga prokuroria e cila ishte përcaktuar me ligj, palët tani po ushtrojnë padi sipas tekeve edhe pas afatit ligjor për padi të tilla ka skaduar. Për sqarim më të hollësishëm Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-12-0098-A0001 të datës 18 shkurt 2016 ka dhen qëndrim juridik

lidhur me ndryshimin e ligjit mbi qarkullimin. Gjithashtu gjykata kushtetuese e Jugosllavisë në atë kohë me datën 27 qershor 1999, me vendimin IU-12-/1-88, IU-101-/1-89 dhe IU-101/2-89 dispozitën e nenit 8 a e ka shpallur dispozitë ligjore jo kushtetuese. Nga këto arsye kjo bazë dhe si i tillë ngelet akt i vdekur në letër i cili nuk gjen zbatim në praktik. Kjo edhe për faktin se i njëjti, është nxjerr për qëllimi politike ekskluzivisht për territorin e Republikës së Kosovës. Tutje nga përmbajtja e Aktgjykimit C.nr.1648/92 vërtetohet se kontrata e shitblerjes janë absolutisht nule, kurse nga pikëpamja formale, kërkesëpadija përmes ankesës është orientuar në kthimin e pronësisë.

AKP ka shtuar se në rastet e nulitetit absolut të kontratës duhet të përmbushet Rregulla e nulitetit e cila konsiston në detyrimin e palëve kontraktuese, ashtu që paditësi me padi është dashur të kërkon kthimin e prestimeve sipas dispozitave të LMD-së e jo kthimin e pronës, sepse te padia e inicuar nga Prokuroria në cilësinë e palëve janë të dyja palët kontraktuale të shitblerjes.

Kjo rregull sipas AKP-së është e logjike sepse në përmbushjen e këtyre kontratave janë dhënë dhe përmbushur prestimet dhe me nulitetin e tyre duhet të rivendoset gjendja e cila ka qene para lidhjes së kontratës, sikur një kontratë e tillë të mos kishte ekzistuar fare. E paditura konsideron se në rastin konkret caktimi i Ekspertit nga lëmi përkatëse duke i obliguar palët të kthejnë krejt atë që kanë marrë sipas bazës së kontratës nule e përcaktuar me nenin 104 1 e LMD-së, duke e kthyer shpërblimin gjegjes në të holla sipas çmimit në kohën e nxjerrjes së aktgjykimit sipas nenit 90 i LMD-së. AKP-ja thekson se ankuesit as me ankesën e paraqitur kundër Aktvendimit C-III-17-0108 të shkallës së I -rë, nuk kanë arritur të paraqesin ndonjë bazë juridike të besueshme dhe as nuk kanë mundur të konstatojnë një gjendje tjetër faktike prej asaj siç ka vërtetuar Gjykata e Shkallës së I-rë.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësve aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë

Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj i njëjti duhet të ndryshohet lidhur me kërkesë padinë pronësore të paditësve, ndërsa çështja lidhur me kërkesën monetare të Kundërpadisë të paraqitur nga AKP-ja kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit përmes të autorizuarit të tyre me 26 mars 2003 ne Gjykatën Komunale në Prizren kanë kërkuar tu njihet e drejta pronësore lidhur me ngastrat kadastrale që ishin objekt i kontratave të shitblerjes të anuluar me Aktgjykimin C.nr.1648/92, të dt. 26.10.1993, në bazë të kërkesës së Prokurorit Publik Komunal në Prizren, kontrata e shitblerje Leg nr.. dt.. kontrata e shitblerjes, Leg nr. dt., dhe kontrata e shitblerjes leg, nr. dt..

Me 17 maj 2010, Gjykata Komunale në Prizren ka marrë Aktgjykim C. nr. 797/03, me të cilin ishte aprovuar padia e paditësve si e bazuar dhe i padituri NSH,, Progres Export " në Prizren ishte obliguar t'ua dorëzojë paditësve në posedim dhe shfrytëzim ngastrat kadastrale në vijim. Kundër këtij Aktgjykimi pala e paditur kishte parashtruar ankesë.

Me 27 prill 2017, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, me Aktvendim AC – II- 12- 0157, ka aprovuar ankesën e të paditurës, dhe ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 797/03, të dt. 17 maj 2010, për shkak se i njëjti ishte marr jashtë kompetencës lëndore dhe çështjen e ka kthye në rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Nga ajo që u cekë më lartë, Kolegji i Apelit vëren se paditësit padinë e tyre pronësore e mbështesin në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.1648/92, të datës 26.10.1993, i cili Aktgjykim e ka klauzolën e plotfuqishmërisë me datë 29.04.1994.

Me këtë Aktgjykim me paragrafin e parë të dispozitivit ishin anuluar të tri Kontratat e shitblerjes Ov.br., dt..., kontrata e shitblerjes, Leg nr. ., dt..., dhe kontrata e shitblerjes Leg, nr. dt.. Këto kontrata ishin të lidhura në mes paraardhësve të paditësve të ndjerë B J N,N J N dhe P J N , të gjithë nga fshati L KK Prizren si dhe të paditurës NSH,,Progres Export “ Prizren.

Me paragrafin e dytë dispozitivit të këtij Aktgjykimi ishte vendosur që palët janë tërhequr nga kërkesat për kthimin e prestimeve që dalin nga Kontratat e anuluarat të shitblerjes.

Tutje në bazë të këtij Aktgjykimi vërehet se paditësit, por edhe NSH-ja që në atë kohë në vitin 1992 nuk kanë kërkuar kthimin e dyanshëm të prestimeve, paditësit kthimin e tokës, ndërsa NSH-ja e paditur kthimin e të hollave.

Mirëpo paditësit me datën 26 mars 2003, ata kanë vendosur të paraqesin padi të re për kthimin e ngastrës lëndore, objekt i të tri Kontratave të anuluarat të shitblerjes, ndërsa AKP-ja me parashtresën e saj të datës 08 shkurt 2023 të dorëzuar në shkallën e I-rë të DHPGJS-së ka paraqitur Kundërpadi ndaj paditësve duke kërkuar kthimin e të hollave të paguara sipas vlerës së ngastrave në datën kur nxirret Aktgjykimi mbi meritat e padisë.

Me kërkesën monetare të Kundërpadisë nuk është marrë fare Kolegji i shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

Kolegji i Apelit konstaton se tërheqja e padisë apo mos paraqitja e kërkesës nga paditësit për kthimin e ngastrave lëndore, pas anulimit të kontratave që ka ndodhur në vitin 1992, nuk mund të paraqesë ndonjë pengesë ligjore që ata përsëri me padi të re ta kërkojnë kthimin e këtyre pronave, siç ata e kanë vepruar me padinë e dorëzuar fillimisht në Gjykatën komunale në Prizren me 26 mars 2003. Sipas nenit 261 paragrafi 5 të LPK-së, “Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri”.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit me parashtresat e tyre të datës 01.07.2020 dhe të datës 22.02.2022 e kanë ngatërruar kërkesën e tyre fillestare të paraqitur me padinë e vitit 2003, duke kërkuar anulimin dhe shpalljen nul të Kontratave lëndore të shitblerjes, mirëpo ata këtë gabim të tyre, në seancën dëgjimore të

mbajtur me 06 prill 2023, dhe në fjalën përfundimtare me shkrim deklarojnë se disa paragraf të këtyre parashtresave janë dhënë gabim, dhe sqarojnë se kërkesa e tyre përfundimtare është kthimi i ngastrave që ishin objekt i kontratave të anuluar të shitblerjes, e jo anulimi i kontratave të shitblerjes.

Kolegji i Apelit konstaton se ishte fakt i ditur për të gjitha palët e përfshira në këtë lëndë, e që kjo vërtetohet edhe me përmbajtjen e parashtresave të tyre të dorëzuara në Gjykatën komunale në Prizren që nga viti 2003, se anulimi i kontratave të shitblerjes tashmë kishte ndodhur në vitin 1992 me Aktgjykimin C.nr.1648/92 të datës 26.10.1993. Prandaj duke u bazuar në këtë fakt mund të konstatohet se ishte tërësisht i gabuar interpretimi i kërkesës së paditësve, që e kishte bërë Kolegji i shkallës së I-rë në Aktvendimin e ankimuar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se me datë 25 janar 2023, Kolegji i shkallës së parë i DHPGJS-së, ka nxjerr Urdhër për bashkimin e padive pronësore , C – III- 17- 0108, C- III- 18- 0109, dhe C- III- 19- 0097, dhe lënda pastaj është udhëhequr me numrin C- III- 17- 0108.

Paditë me kërkesa të njëjta pronësore janë dorëzuar në kohë të ndryshme, dhe njëra prej tyre ishte dorëzuar edhe tek Autoriteti i Likuidimit, i cili kërkesën e ka refuzuar si të papranueshme, me arsyetimin se edhe pas kërkesës për të dorëzuar prova shtesë, paditësit nuk e kanë mbështetur kërkesën me prova të mjaftueshme.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se në lëndën e bashkuar, C-III-17-0108, si përfaqësues me autorizim bartës janë paraqitur Avokatët B M dhe S A D, dhe kërkesat e tyre të paraqitura në lëndën e bashkuar, konsiderohen se janë paraqitur në emër të gjithë paditësve të përfshirë në tri lëndët e bashkuara.

Kolegji i Apelit vëren se Urdhri për bashkimin e lëndëve u është dërguar palëve të përfshira në këto lëndë, dhe ata kanë qenë të njoftuar se Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së i ka bashkuar këto tri lëndë.

Tutje kolegji i Apelit vëren se kërkesa përfundimtare e paditësve ishte paraqitur në seancën dëgjimore, dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim. Në seancën dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare, avokati i paditësve B M ka kërkuar kthimin

e ngastrave vijuese kadastrale, nr... nr. ., nr., nr., nr., nr., nr., nr.,nr.. nr., nr., nr.,nr. .dhe ., ZK L KK Prizren, dhe kjo kërkesë mund të interpretohet se ishte kërkesëpadia e përfundimtare e paditësve, për të cilën ata kanë kërkuar nga gjykata që të vendosë në merita të padisë, e për të cilët edhe gjykata ka vërejtur se parcelat kadastrale në fjalë kanë qenë objekt i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.1648/92 i dt.26.10.1993.

Kolegji i Apelit vëren se aktiviteti procedural i Kolegjit të shkallës së I-rë në këtë lëndë, gjatë procedurës me shkrim ishte i shumanshëm në drejtim të sqarimit të shumë çështjeve që ndërlidhen edhe me merita të padisë.

Kolegji i shkallës së I-rë ka lëshuar disa urdhra për palët e përfshira në këtë lëndë, me të cilat janë parashtruar kërkesa të ndryshme për palët e përfshira në lëndën e bashkuar, e që ndërlidhen edhe me meritat e padisë. Madje në këtë lëndë është mbajtur edhe seancë dëgjimore.

Ky aktivitet procedural i zhvilluar gjatë procedurës me shkrimi nga Kolegji i shkallës së I-rë në përmbajtjen e tij, dhe parashtruesat e shumta të dorëzuara në mes palëve, të japin për të kuptuar se në këtë lëndë të bashkuar, janë shqyrtuar edhe meritat e padisë, mirëpo në fund të këtij procesi, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së, nuk ka vendosur në merita të padisë, por ka vendosur ta hedhë padinë si të papranueshme, duke nxjerrë konstatimin e gabuar se bëhet fjalë për çështje të gjykuar-resjudikata. Është e qartë se deri te kjo ka ardhë për shkak të interpretimit të gabuar të kërkesës së paraqitur të paditësve.

Siç u tha më sipër kërkesa e fundit e paditësve e paraqitur në seancën dëgjimore por edhe në fjalën përfundimtare me shkrim, ishte njohja e të drejtës së pronësisë dhe kthimi i ngastrave lëndore, që ishin objekt i Kontratave të anuluar të shitblerjes. Kjo kërkesë vërehet se nuk është marrë për bazë nga Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së.

Prandaj duke u bazuar në këtë gjendje faktike, mund të konstatohet se hedhja poshtë e padisë pronësore të paditësve duke e konsideruar kërkesë padinë e tyre si çështje të gjykuar, ishte veprim i gabuar i Kolegjit të shkallës së I-rë. Në fakt ky veprim i gabuar i Kolegjit të shkallës së I-rë ka shkaktuar edhe privimin e të drejtës

së palëve të përfshira në këtë procedurë edhe ashtu të tej zgjatur, që të marrin nga gjykata një vendim gjyqësor mbi meritat e padisë.

Duke e marrë në konsideratë tërë përmbajtjen e aktivitetit të tërësishëm procedural të Kolegjit të shkallës së I-rë në këtë lëndë, si dhe përmbajtjen e parashtresave të shumta të palëve të dorëzuara në mes tyre gjatë procedurës me shkrim, e të cilat për objekt kanë aspekte të ndryshme edhe të meritave të padisë, Kolegji i Apelit konsideron se palëve në shkallën e I-rë të DHPGJS-së u është dhënë mundësia e duhur e dëgjimit edhe për aspekte të meritave të kërkesë padisë së paditësve. Për më tepër kjo mundësi, palëve u është dhënë edhe gjatë procedurës me shkrim pranë Kolegjit të Apelit.

Prandaj duke i marrë në konsideratë këto rrethana faktike të kësaj lënde, Kolegji i Apelit konsideron se nuk ka asnjë pengesë të natyrës ligjore apo faktike, që çështja kontestuese e lidhur me kërkesë padinë e paditësve, në këtë fazë të procedurës të trajtohet në merita të padisë.

Kolegji i Apelit e ka në konsideratë faktin se AKP-ja me parashtresën e saj të datës 08 shkurt 2023 ka paraqitur kundërpadinë ndaj paditësve, mirëpo kërkesa monetare e Kundërpadisë, nuk mund të trajtohet në këtë fazë të procedurës. Është e qartë se Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së e ka injoruar tërësisht Kundërpadinë, dhe fare nuk është marr me kundërpadinë në Aktvendimin e ankimuar.

Kolegji i Apelit vëren se lidhur me Kundërpadinë e paraqitur nga AKP-ja, nuk janë marrë veprimet e duhura ligjore nga procedura me shkrim dhe po ashtu vërehet se paditësit nuk janë deklaruar ende lidhur me kundërpadinë. Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit ka vendosur që çështja lidhur me kërkesën monetare të Kundërpadisë duhet të kthehet në rigjykim. Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së në procedurën në vazhdim duhet ta trajtoj edhe kërkesën monetare të Kundërpadisë të paraqitur nga AKP-ja në emër të NSH-së së paditur.

Bazuar në këtë gjendje faktike që u cek më lartë, Kolegji i Apelit konstaton se paditësit kërkesën e tyre për kthimin e pronave, dhe AKP-ja kërkesën e saj monetare të Kundërpadisë për kthimin e të hollave, e bazojnë në Aktgjykimin e

Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.1648/92 të datës 26.10.1993, i cili është bërë i formës së prerë me datë 29.04.1994.

Zbatimi i parimit të sigurisë ligjore për palët e përfshira në procedurë

Aktgjykimet dhe aktvendimet e formës së prerë të nxjerra para hyrjes në fuqi të nenit 4.5 e LDHP-së të vitit 2012, dhe të nenit 5.7 nën-pika 7.1 i LDHP-së në zbatim, nuk duhet të konsiderohen nul dhe pa efekte juridike, edhe nëse janë nxjerrë për rastet që bien në kompetencë të Dhomës së Posaçme.

Në këtë rast padia për anulimin e kontratës së shitblerje Leg nr. ., të datës 23.11.1963, kontrata e shitblerjes, Leg nr. ., të datës 04.10.1963, dhe kontrata e shitblerjes Leg, nr. ., dt..., ishte paraqitur në bazë të kërkesës së Prokurorit Komunal Publik në vitin 1992, në Gjykatën Komunale në Prizren, do të thatë 10 vite më herët para se të themelohet DHPGJS-ja. Padia në ato kohë ishte paraqitur në Gjykatën kompetente.

Lidhur me pyetjen e vendimeve të nxjerra nga gjykatat kompetente, sistemet ligjore në përgjithësi përgjigjen duke u thirrur në parimin e sigurisë ligjore me vërtetim të plotfuqishmërisë së aktgjykimit (*'res judicata'*), që mbulon dhe rregullon të gjitha format e parregullsive të shkaktuara si pasojë e mungesës së juridiksionit apo ndonjë parregullsie tjetër procedurale që mund të jetë shkaktuar nga Gjykata përkatëse, që ka vendosur për rastin.

Edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka inkorporuar këtë arsyetim në koncept të së drejtës për gjykim të drejtë. Në aktgjykimin e rastit të XHERAJ v. ALBANIA (Kërkesa nr. 37959), e datës 29.07.2008, thuhet si në vijim:

51. Gjykata rithekson se në përputhje me preambulën e Konventës, sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët e Shteteve Kontraktuese, një nga aspektet themelore e së cilës është parimi i sigurisë juridike, që ndër të tjerash kërkon se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, aktvendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (*shih Brumărescu v. Rumania* [GC], nr. 28342/.. § 61, ECHR 1999 VII).

52. Për më tepër, Gjykata vëren se kushtet e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Shmangia nga ky parim justifikohet vetëm nëse ka qenë e domosdoshme të bëhet si rezultat i rrethanave të një karakteri thelbësor dhe detyruës (Ryabykh k. Rusi, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003 IX), ose nëse vlerësimet serioze legjitime janë më të rëndësishme sesa parimi i sigurisë juridike (shih *Bratyakin v. Rusi* (dhjetor), nr. 72776/01, 9 mars 2006).

Dhe ne mund të gjejmë ritheksimin e kësaj deklarate në rastet e *Sovtransavto Holding v. Romani* (Kërkesa nr. 48553, 25.07.2002), *Androne v. Romani* (Kërkesa nr. 54062/00, 22.12.2004) dhe *SC Plastick ABC SA v. Ukrainë* (Kërkesa nr. 32299, 7.02.2008).

Në fakt Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton në nenin e saj 22 se të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, dhe në rast konflikti kanë prioritet ndaj dispozitave të ligjit’.

Prandaj është e qartë se në rastin konkret bëhet fjalë për një Aktgjykim që është i formës së prerë, dhe i cili për shkak të parimit të sigurisë ligjore të palëve nuk ka mundësi më të rishikohet. Prandaj Aktgjykimi i Gjykatës komunale në Prizren, C.nr.1648/92 i datës 26.10.1993, është bazë për kthimin e prestimeve të dy anshme të palëve, që ishin subjekt i kontratave të anuluar të shitblerjes.

Prandaj duke marrë për bazë këtë fakt, dhe faktin tjetër se gjatë tërë procedurës Kolegji i shkallës së I-rë në aktivitetin e tij procedural gjatë procedurës me shkrim, dhe në seancën e mbajtur dëgjimore, është marrë edhe me meritat e padisë, por që nuk ka vendos lidhur me meritat e padisë, Kolegji i Apelit nxjerrë konstatimin se paditësit kanë të drejtë tu njihet e drejta e pronësisë dhe atyre tu kthehen në posedim ngastrat e përfshira në pikën **III** të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, të cilat ngastra edhe janë kërkuar nga paditësit me kërkesën e fundit të tyre të paraqitur në seancën dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare me shkrim.

Prandaj mund të konstatohet se paditësit e kanë një titull të vlefshëm pronësor një Aktgjykim të formës së prerë, me të cilën ishin anuluar të tri kontrata lëndore e shitblerjes, dhe atyre duhet tu kthen këto ngastra.

Tutje Kolegji i Apelit konstaton se ky Aktgjykim në bazë të nenit 104 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 po ashtu është bazë edhe për kërkesën monetare të Kundërpadisë të paraqitur nga AKP-ja në emër të NSH-së së paditur, e cila Kundërpadi do të trajtohet në procedurën në vazhdim, nga Kolegji i shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

Prandaj ky Aktgjykim që është formës së prerë, bazuar në nenin 20 paragrafi 2 dhe nenit 37 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore të vitit 1980, dhe nenit 104 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, është bazë ligjore, që paditësve tu kthehet e drejta e pronësisë lidhur me ngastrat e cekura në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Kolegji i Apelit konstaton se Aktvendimi për caktimin e masës së sigurisë i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-17-0108 i datës 13 nëntor 2020, pas vendosjes në merita lidhur me kërkesë padinë e paditësve, ai më nuk mund të prodhoj efekte juridike, lidhur me ngastrat që ishin objekt i këtij Aktvendimi.

Me sa u tha më sipër, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Ankuesit/paditesit e kanë paguar taksën gjyqësore më 26 prill 2024 në shumë prej 100 euro, në bazë të nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, andaj nuk ngarkohen me taksë shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 08 gusht 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____